

KUSHTET DHE AFATET E PERGJITHSHME TE "PROMOVIMIT TË SAMSUNG GALAXY S21 FE 5G"

Përpara se të blini një Samsung Galaxy S21 FE 5G ju lutem lexoni Kushtet dhe Afatet e Promovimit (në vijim referuar si "**Rregullat**"):

1. Organizatori i Promovimit

Samsung Electronics Austria GmbH, me seli në Vjenë në adresën Praterstrasse 31/14 Obergeschoss, Vjenë, Austri dhe regjistruar me numër regjistrimi FN 217924b (në vijim referuar si „**Samsung**”), organizon promovimin e Samsung Galaxy S21 FE 5G.

2. Periudha e promovimit dhe Dhurata

Blerësit privatë dhe biznes të cilët blejnë pranë një prej partnerëve të autorizuar të shitjeve Samsung të listuar në këto Rregulla, një Samsung Galaxy S21 FE 5G gjatë periudhës së promovimit nga 21.03.2022 deri më 17.04.2022 dhe që plotësojnë kushtet e tjera të përcaktuara në këto Rregulla, do të përfitojnë si dhuratë një Samsung Galaxy Watch4 44mm ngjyrë të zezë (në vijim: **Dhurata**). Afati i promovimit mund të përfundojë më herët, në varësi të stokut të Dhuratave.

3. Kushtet e Blerjes

Blerja e pajisjeve Samsung Galaxy S21 FE 5G mund të kryhet pranë partnerëve të shitjes së Samsung të listuar në pikën 6 të këtyre Rregullave, me kusht përmbushjen në mënyrë kumulative të të gjitha kushteve vijuese:

- a. Blerësi blen një pajisje Samsung Galaxy S21 FE 5G gjatë periudhës së promovimit;
- b. Pajisja blihet pranë partnerit të autorizuar të shitjeve të Samsung në territorin e Republikës së Shqipërisë; Lista e partnerëve të autorizuar përcaktohet në pikën 6 të këtyre Rregullave;
- c. Blerësi porosit / blen pajisjen si përdorues fundor; Përdoruesit fundorë janë personat fizik ose juridik në territorin e Republikës së Shqipërisë të cilët kanë porositur / blerë pajisjen për qëllimet e tyre vetjake dhe jo me qëllim porositjen apo shpërndarjen e mëtejshme;

Pajisjen e blerë, përdoruesi e regjistron në faqen <https://www.samsung.com/al/offer/move-and-grab-the-gift>

- d. deri në datën 15.05.2022, në përputhje me pikën 6 të këtyre Rregullave.

4. Regjistrimi i pajisjeve për blerësit e Samsung Galaxy S21 FE 5G

Parakushti për marrjen e Dhuratës është regjistrimi i pajisjes së blerë gjatë periudhës së promovimit, pra i Samsung Galaxy S21 FE 5G. Regjistrimi duhet të kryhet në faqen web <https://www.samsung.com/al/offer/move-and-grab-the-gift> .

Procesi i regjistrimit përfshin vendosjen e të dhënave të nevojshme për regjistrimin e suksesshëm. Të dhënat që mblidhen me qëllim që blerësi i Samsung Galaxy S21 FE 5G të ketë të drejtën të përfitojë Dhuratën, dhe me qëllim dërgimin e Dhuratës pas regjistrimit të suksesshëm janë:

- Emri dhe mbiemri i përdoruesit ose emri i shoqërisë,
- Adresa e e-mailit e përdoruesit të pajisjes,
- Adresa e banimit e përdoruesit të pajisjes në territorin e Republikës së Shqipërisë (me qëllim dërgimin e Dhuratës),
- Numri IMEI dhe numri serial i pajisjes së blerë,
- Paraqitje / skanim i faturës tatimore për pajisjen e blerë

Duke klikuar mbi butonin e dërgimit, përdoruesi i dërgon të dhënat Samsung dhe nënkontraktuesve të tij me qëllim verifikimin e plotësimit të kushteve, pra nëse përdoruesi ka fituar të drejtën për të marrë Dhuratën, dhe përdoruesi jep gjithashtu pëlqimin e shprehur për përdorimin e të dhënave të tij personale në përputhje me parashikimet e këtyre Rregullave. Pranimi i këtyre Kushteve dhe Afateve është i domosdoshëm që procesi i regjistrimit të konsiderohet i suksesshëm.

Nëse të dhënat paraqiten në përputhje me këto Rregulla, Dhurata do t'i dërgohet përdoruesit në mënyrën dhe brenda afateve të përcaktuara në këto Rregulla.

5. Dorëzimi i Dhuratës

Dorëzimi i Dhuratës për blerësit e Samsung Galaxy S21 FE 5G me kusht që të jenë regjistruar me sukses në faqen web vendase të Samsung në përputhje me këto Rregulla, do të kryhet deri më 30.06.2022 pranë adresave të paraqitura gjatë regjistrimit në faqen web vendase të Samsung, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Dërgimi i Dhuratës do të kryhet me shpenzimet e Organizuesit.

6. Partnerët e Autorizuar të Samsung

Blerja e pajisjeve Samsung mund të kryhet vetëm pranë partnerëve të autorizuar të shitjes së Samsung të mëposhtëm:

1. One Telecommunications Sh.a.
2. Neptun SH.P.K.
3. Globe Shops SH.P.K.

7. E drejta e ndryshimit të kushteve të promocionit

Samsung rezervon të drejtën të ndryshojë këto Rregulla në çdo kohë, për arsye të justifikuara, me detyrimin që t'i publikojë pa vonesë.

NJOFTIM PËR MBLEDHJEN DHE PËRDORIMIN E TË DHËNAVE PERSONALE

Samsung Electronics Austria GmbH, me seli në adresën Praterstrasse 31/14 Obergeschoss, Vjenë, Austri, ju njofton lidhur me informacionin mbi përpunimin e të dhënave personale:

1. Kontrolluesi

Kontrolluesi i të dhënave është Samsung Electronics Austria GmbH, me seli në adresën Praterstrasse 31/14 Obergeschoss, Vjenë, Austri, nëpërmjet Degës Samsung Electronics Austria GmbH (në vijim referuar si **"Kontrolluesi"**).

2. Të dhënat që do të mblidhen

Kontrolluesi do të mbledhë dhe përpunojë të dhënat personale të mëposhtme:

- Emri dhe mbiemri
- Adresa e e-mailit e blerësit
- Adresa e banimit e blerësit në territorin e Republikës së Shqipërisë (me qëllim dërgimin e Dhuratës)
- Numri IMEI dhe numri serial i Pajisjes së blerë,

(referuar bashkërisht si **"të Dhënat Personale"**)

3. Qëllimi i mbledhjes së të Dhënave Personale

Kontrolluesi do të mbledhë dhe përpunojë të Dhënat Personale të mësipërme vetëm për qëllimin e përcaktimit të të drejtës për të marrë pjesë në Fushatën Promocionale "Samsung Galaxy S21 FE 5G" dhe dërgimin e Dhuratave në rast se ushtrohet e drejta për to.

4. Mënyra e përdorimit të të Dhënave Personale

Të Dhënat Personale të mbledhura bazuar në pëlqimin e dhënë do të përdoren vetëm për qëllimin e mësipërm të Kontrolluesit, në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (Ligji) dhe Politikat e Privatësisë së Kontrolluesit bashkëngjitur më poshtë.

5. Baza ligjore për përpunimin e të Dhënave Personale

Kontrolluesi mbledh dhe përpunon të Dhënat Personale bazuar në pëlqimin vullnetar të subjektit të të dhënave personale.

6. Afati për mbajtjen e të Dhënave Personale

Të Dhënat Personale do të mbahen vetëm për nevojën e përmbushjes së qëllimi të mësipërm, dhe në çdo rast, jo më gjatë se 6 muaj nga data e blerjes.

7. Të drejtat tuaja

Me kërkesë të pjesëmarrësve, Kontrolluesi i të Dhënave Personale do të shtojë, përditësojë dhe fshijë të Dhënat Personale nëse të dhënat janë të paplota, të gabuara ose të pasakta dhe nëse përpunimi i tyre nuk është në përputhje me Ligjin ose nëse qëllimi për mbledhjen e të Dhënave Personale është përmbushur. Për më tepër informacion lexoni Politikat e Privatësisë tonat ose na kontaktoni me e-mail në dataprotection.sead@samsung.com.

Në rast se pjesëmarrësit besojnë se përpunimi i të dhënave të tyre personale cënon privatësinë e tyre, ata mund të kontaktojnë Kontrolluesin e të dhënave personale ose Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe të kërkon shpjegim.

8. Informacione të tjera

Për informacion të detajuar mbi masat e marra për mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe për çdo zbulim të të Dhënave Personale, lexoni Politikën e Privatësisë tonat.